

**DISPOZITAT E LIGJIT PËR LËNDËT PLASËSE TË CILAT NDRYSHOHEN**  
("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", numër 49/08)

**Llojet dhe përkufizimet e lëndëve plasëse**

**Neni 3**

Lëndët plasëse, në kuptim të këtij ligji, janë lëndët kimike të ngurta dhe të lëngshme, karakteristika e të cilave është që nën ndikimin e veprimit të jashtëm (goditje ose fërkim), nëpërmjet shpërbërjes shpërthyes kimike, çlirojnë energji në formë nxehtësie ose gazi.

Lëndët plasëse të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 1) lëndë plasëse për qëllime tregtare;
- 2) pajisjet për ndezëse;
- 3) pajisjet piroteknike;
- 4) municionet për qëllime tregtare;
- 5) barutet;
- 6) produktet e mbushura me lëndë plasëse;
- 7) lënda e parë me karakter shpërthyes për prodhim të lëndëve të përmendura në pikat 1 deri 6 të këtij paragrafi.

Lëndët plasëse për qëllime tregtare janë lëndë të cilat përdoren për shkatërrimin ose formësimin e objekteve dhe lëndëve nëpërmjet energjisë çliruar me reaksion kimik të shpërbërjes plasëse.

Pajisjet për ndezjen e plasësve janë kapsollat e të gjitha llojeve, ndezësit, fitilat dhe pajisjet piroteknike të cilat përdoren për veprimtari minerare.

Pajisjet piroteknike janë pajisje të cilat përdoren për fishekzjarrët, raketat kundër breshrit dhe raketa të tjera të cilat përdoren për qëllime shkencore, tregtare dhe të tjera, si dhe mallra të cilët përmbajnë përbërës zhurmues me veprim shpërthyes ose përbërës të tjerë të cilët shërbejnë për prodhuar zjarr, dritë, plasje ose tym.

Municione për qëllime tregtare janë fishekët, plumbat dhe gëzhojat e përgatitura me kapsula dhe të mbushura me barut.

Barutet janë lëndë plasëse të cilat digjen me përcjelljen e nxehtësisë dhe synohen kryesisht për hedhje të raketave, ndërsa ndahen në barute të zinj dhe me tym të pakët.

Produktet e mbushura me lëndë plasëse janë produkte të cilët janë mbushur me përzjerje plasëse dhe/ose piroteknike, efekti i të cilëve varet nga këto lëndë.

Lëndët e para me karakter plasës janë lëndë të cilat sipas përbërjes kimike dhe ndjeshmërisë ndaj ndezjes, kanë karakteristikat e plasësit dhe janë të afta për shpërbërje shpërthyes, ndërsa janë synuar për prodhimin e lëndëve plasëse.

**Përkufizime**

**Neni 5**

Terma të veçantë të përdorur në këtë ligj kanë kuptim si vijon:

- 1) **riciklimi (çmontimi)** është ripërdorimi i lëndëve plasëse për qëllime të tjera pas heqjes së lëndëve plasëse nga municioni dhe pajisjet shpërthyes të minave;
- 2) **neutralizimi** është ndryshimi kimik i lëndës plasëse në lëndë joplasëse;
- 3) **asgjësim i lëndës plasëse** nënkupton asgjësimin e plotë të lëndës plasëse me djegie, detonim ose procedura të tjera;
- 4) **furnizuesi** është prodhuesi, përfaqësuesi i tij me seli në Mal të Zi, importuesi ose shoqëria tregtare, personi juridik ose sipërmarrës i cili tregon lëndën plasëse ose mundëson përdorimin e saj;
- 5) **përdorim** është përgatitja e drejtpërdrejtë dhe aktivizimi i lëndëve plasëse;
- 6) **administrim** janë veprimet e ndërmarra nga personat fizikë që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj, gjatë prodhimit, testimit, magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të lëndëve plasëse;
- 7) **personi përgjegjës** është personi fizik në shoqërinë tregtare, në personin juridik ose te sipërmarrësi, i cili është përgjegjës për procesin e prodhimit, testimit, tregtimit dhe përdorimit të lëndëve plasëse, në përputhje me këtë ligj;
- 8) **magazinim** është magazinimi dhe vendosja e lëndëve plasëse në objektet e prodhimit dhe

të magazinimit, në arka të lëvizshme dhe kontejnerë;

9) **objekti i prodhimit** është objekt i ndërtuar dhe i kontrolluar me hapësirën përkatëse, i cili është i synuar për prodhimin e lëndëve plasëse dhe i ndërtuar e pajisur në mënyrë që të garantojë mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës;

10) **objekti i magazinimit** është objekti i ndërtuar dhe kontrolluar me hapësirën përkatëse, i cili është i synuar për magazinimin, ngarkimin dhe shkarkimin e lëndëve plasëse, ndërtuar e pajisur në mënyrë që të garantohet jeta, shëndeti dhe siguria e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës;

11) **arkë e lëvizshme** është objekt për magazinimin e municionit, barutit të gjuetisë, kapsulave për municionin e gjuetisë, të lëndëve piroteknike, të fitilit me djegie të ngadaltë dhe pajisjeve ndihmuese për ndezje, me kusht që sasia e përgjithshme e barutit, përfshirë edhe barutin në municion, nuk kalon sasinë prej 20 kg ose 150 kg për pajisjet piroteknike;

12) **kontejner** është arkë e lëvizshme ose transporti për magazinimin e lëndëve plasëse.

## II. MASAT E SIGURISË

### Masat parandaluese dhe mbrojtëse

#### Neni 6

Gjatë prodhimit, testimit, tregtimit, përdorimit, magazinimit, riciklimit (çmontimit), neutralizimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse, shoqëria tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrësit garantojnë mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës dhe zbatojnë masat e përcaktuara me këtë ligj, aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe aktet nënligjore me të cilat janë rregulluar mbrojtja dhe shpëtimi, mbrojtja në punë, mbrojtja shëndetësore, mbrojtja e mjedisit, planifikimi dhe rregullimi i territorit dhe i ndërtimit të objekteve.

Mënyra e zbatimit të masave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni rregullohet me aktin e përgjithshëm të shoqërisë tregtare, të personit juridik ose sipërmarrësit.

#### Neni 7

Shoqëritë tregtare, personat juridikë ose sipërmarrësit të cilët kryejnë prodhim, testim, tregtim, përdorim, magazinim, riciklim (çmontim), neutralizim dhe asgjësim, njoftojnë personat të cilët administrojnë lëndët plasëse ose kryejnë veprime të tjera në lidhje me to, për masat e përcaktuara me aktet e përmendura në nenin 6 paragrafi 2 të këtij ligji, si dhe i kualifikojë ata për veprimet në rast aksidenti tekniko-teknologjik ose rreziku tjetër, në bazë të dispozitave për ruajtjen dhe shpëtimin.

### Zona e rrezikut

#### Neni 11

Në zonat e kërcënuara nga objektet e përmendura në nenin 8 të këtij ligji, nuk mund të miratohet ndërtimi i objekteve të tjera me përjashtim të atyre që shërbejnë për sigurimin e këtyre objekteve.

Kufijtë e zonave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni rregullohen me akt nënligjor të ministrisë.

### Leja për tregtim

#### Neni 12

Lënda plasëse mund të tregtohet dhe të përdoret vetëm në qoftë se shoqërohet me lejen për prodhim.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni jepet nga ministria me kërkesë të furnizuesit.

Leja për tregtimin e lëndës plasëse jepet me kusht që të vlerësohet përputhshmëria e saj me kërkesat teknike në procedurën e përcaktuar dhe të treguar në përputhje me këtë ligj.

Me kërkesën për leje të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, bashkëngjiten:

- certifikata e përputhshmërisë me kërkesat teknike;
- udhëzimi për përdorimin, magazinimin dhe asgjësimin e lëndës plasëse;
- të dhënat për shënimet dhe mënyrën e shënimit të lëndës plasëse.

Udhëzimi i përmendur në paragrafin 4 ndarja 2 e këtij neni duhet të jetë shkruar në mënyrë të kuptueshme, në gjuhën malazeze.

Kërkesat teknike dhe procedurat për vlerësimin e përputhshmërisë së lëndëve plasëse, si dhe shënimet dhe mënyra e shënimit të lëndës plasëse, përcaktohen me rregulloren teknike të lëshuar nga ministria në bashkëpunim me organin shtetëror përgjegjës për çështjet e zhvillimit ekonomik.

### ***Leja për prodhim***

#### **Neni 22**

Prodhues mund të jetë shoqëria tregtare ose person juridik dhe sipërmarrës që është regjistruar për prodhimin e lëndëve plasëse dhe që ka leje për prodhim të lëndëve plasëse.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet nga ministria.

Leja për prodhim mund të përmbajë kërkesa shtesë për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës.

### ***Kushtet për prodhim***

#### **Neni 23**

Prodhuesi duhet të ketë:

- Person përgjegjës;
- Persona që do të administrojnë lëndët plasëse gjatë procesit të prodhimit;
- Objekt për prodhimin dhe magazinimin.

Personi përgjegjës i përmendur në paragrafin 1 ndarja 1 i këtij neni zotëron diplomë universitare për degën përkatëse dhe plotëson kushtet për administrimin të përmendura në nenin 19 të këtij ligji.

### ***Kërkesa për leje për prodhim***

#### **Neni 24**

Prodhuesi, bashkë me kërkesën për leje për prodhim të lëndëve plasëse, bashkëlidh:

- Aktin për regjistrim në Regjistrin Qendror të gjykatës Tregtare;
- Të dhënat për personin përgjegjës;
- Të dhënat për personat të cilët do të administrojnë lëndët plasëse gjatë procesit të prodhimit;
- Lejen e përdorimit për objektin e prodhimit dhe magazinimit;
- Provat për plotësimin e kushteve të përmendura në nenet 6, 7 dhe 8 të këtij ligji;
- Të dhëna për emrin dhe llojin e lëndëve plasëse që do të prodhohen;
- Studim mbi procedurën teknologjike të përpunimit, dhe
- Përshkrim të sistemit të kontrollit të cilësisë.

### ***Riciklimi (çmontimi) dhe neutralizimi***

#### **Neni 25**

Prodhuesi mund të kryejë riciklim (çmontim) dhe neutralizim të lëndëve plasëse

### ***Magazinimi në objektin e magazinimit***

#### **Neni 27**

Prodhuesi i magazinon lëndët plasëse në objektet e magazinimit të cilët janë pjesë përbërëse e objekteve të prodhimit.

### ***Përkufizim***

#### **Neni 31**

Me tregtim të lëndëve plasëse, brenda kuptimit të këtij ligji, nënkuptohet shitja e lëndëve plasëse të shoqëria tregtare, personi juridik, sipërmarrësi dhe personi fizik, i cili ka leje për blerje të lëndëve plasëse, si dhe për magazinimin e lëndëve të blera.

Me tregtim të lëndëve plasëse brenda kuptimit të këtij ligji nuk konsiderohet shitja me pakicë e pajisjeve piroteknike për argëtim të kategorisë I dhe II, municionet, barutet, fitili me djegie të ngadaltë dhe kapsolla ndezëse për municionin në objektet e shitjes të shoqërive tregtare, personave juridikë dhe sipërmarrësve, për të cilët është dhënë leja për tregtim, në përputhje me rregulloren të veçanta.

### ***Kushtet për tregtimin***

#### **Neni 33**

Shoqëria tregtare, personi juridik dhe sipërmarrësi të përmendur në nenin 32 paragrafi 1 të këtij ligji, duhet të kenë:

- Person përgjegjës;
- Objekt për magazinimin, d.m.th. magazina për të cilat është dhënë leje përdorimi.

Personi përgjegjës i përmendur në paragrafin 1 ndarja 1 i këtij neni zotëron diplomë universitare për degën përkatëse dhe plotëson kushtet për administrimin të përmendura në nenin 19 të këtij ligji.

## **5. Prokurimi**

### ***Leja për prokurim***

#### **Neni 37**

Leja për prokurim të lëndëve plasëse jepet nga ministria me kërkesë të shoqërisë tregtare, personit juridik, sipërmarrësit dhe personit fizik, i cili ka leje për blerja të lëndëve plasëse.

Leja për prokurim të lëndëve plasëse jepet për një periudhë tre mujore.

Kërkesa për lejen e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban të dhënat për:

- aplikantin (emri dhe selia, pra emri dhe mbiemri, adresa dhe numri i kartës së identitetit);
- emrin, sasinë, mënyrën e paketimit, prodhuesin e lëndës plasëse, shkaqet dhe arsyetimet për prokurimin;

- vendin dhe kohën e përafërt të përdorimit;
- personin që do të marrë në ngarkim lëndët plasëse;
- personin që do të administrojë lëndët plasëse;
- mënyrën dhe kushtet e magazinimit.

Ministria mund t'i caktojë aplikantit për leje për prokurim të lëndëve plasëse, masa shtesë sigurie ose masa të tjera të nevojshme për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës.

### ***Leja e personit fizik për blerje***

#### **Neni 38**

Personi fizik mund të marrë një autorizim për blerje për një sasi maksimale jo më shumë se pesë kilogram lëndë plasëse, 50 copë pajisje për ndezje dhe sasia përkatëse e fitilit me djegie të ngadaltë.

Lëndët plasëse të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni mund të administrohen vetëm nga personi të cilit i është dhënë autorizimi për kryerjen e veprimtarive minerare, në përputhje të këtij ligji.

Në lejen për blerje të lëndëve plasëse që i jepet personit fizik, përcaktohet edhe vendi i blerjes së kësaj lënde, që është vendi më i afërt i përdorimit të lëndës plasëse.

Personi fizik që ka blerë lëndët plasëse, pas përdorimit, i kthen pjesën e mbetur të këtyre lëndëve shoqërisë tregtare, personit juridik ose sipërmarrësit, nga i cili e ka blerë lëndën plasëse ose garanton asgjësimin e tyre nga person kompetent dhe për këtë, njofton ministrinë dhe organin administrativ kompetent për çështjet e policisë.

Personi fizik që blen pajisjet piroteknike të kategorisë I dhe II për përdorim personal nuk duhet të ketë leje për blerje.

### ***Kontejneri për magazinim***

#### **Neni 42**

Shoqëria tregtare, personi juridik dhe sipërmarrësi që kryejnë veprimtari minerare janë të detyruar që në kantieret e ndërtimit të kenë kontejnerë për magazinimin e lëndëve plasëse të papërdorura.

## **6. Përdorimi**

### ***Vendi i përdorimit***

#### **Neni 43**

Lëndët plasëse mund të përdoren në vende të cilat janë përcaktuar në lejen për blerje ose përdorimin e këtyre lëndëve.

## ***1)Përdorimi i pajisjeve piroteknike***

### **Llojet e pajisjeve piroteknike**

#### **Neni 45**

Pajisjet piroteknike, në varësi të sasisë dhe llojit të përzierjes piroteknike, d.m.th. mbushja plasëse, fortësia e zhurmës dhe kushtet e tjera të sigurisë, ndahen në:

- Pajisje piroteknike të kategorisë I – lodra piroteknike
- Pajisje piroteknike të kategorisë II – pajisje për fishekzjarrë të vegjël;
- Pajisje piroteknike të kategorisë III – pajisje për fishekzjarrë të mesëm;
- Pajisje piroteknike të kategorisë IV – pajisje për fishekzjarrë të mëdhenj.

Llojet, karakteristikat, etiketimin, kushtet e sigurisë, kushtet e magazinimit dhe përdorimit të pajisjeve piroteknike, përcaktohen me rregullore të ministrisë.

### **Kushtet për kryerjen e veprimtarive me fishekzjarrë publikë**

#### **Neni 47**

Shoqëria tregtare, personi juridik dhe sipërmarrësi të përmendur në neni 46 paragrafi 1 i këtij ligji, duhet të kenë:

- Person përgjegjës;
- Objekt për magazinimin, pra magazina për të cilat është dhënë leja e përdorimit;
- Të paktën një punonjës i cili është i kualifikuar profesionalisht për hedhjen e fishekzjarrëve publike.

Personi përgjegjës i përmendur në paragrafin 1 ndarja 1 të këtij neni, zotëron diplomë kolegji ose universitare për degën përkatëse dhe plotëson kushtet për administrim të përmendura në nenin 19 të këtij ligji.

Programi dhe mënyra e kualifikimit profesional dhe e dhënies së provimit profesional për personin që kryen hedhjen e fishekzjarrëve publike përcaktohet me rregullore të ministrisë.

### **Llojet e fishekzjarrëve**

#### **Neni 50**

Fishekzjarrët publikë janë fishekzjarrë profesional dhe fishekzjarrë për efekte skenike.

Fishekzjarrët profesionale hidhen me mjete piroteknike të miratuara të kategorisë II, III dhe IV, në sipërfaqet që janë përgatitur posaçërisht për këtë qëllim dhe në largësinë e nevojshme nga objektet, mjetet e komunikacionit dhe ambientet e tjera.

Fishekzjarrët për efekte skenike hidhen në teatër dhe institucione të ngjashme, në studio filmike dhe televizive ose në ambient të hapur të miratuar për pajisjet piroteknike të kategorisë I, II, III dhe IV, si dhe lëndët e tjera plasëse të cilat përdoren për këtë qëllim.

### **Leja për hedhjen e fishekzjarrëve publike**

#### **Neni 51**

Leja për hedhjen e fishekzjarrëve publike jepet me kërkesë të shoqërisë tregtare, personit juridik dhe sipërmarrësit të cilët kanë leje për hedhjen e fishekzjarrëve publike.

Me lejen për hedhjen e fishekzjarrëve publike caktohet lloji dhe kategoria e pajisjeve piroteknike për këtë qëllim, si dhe vendi dhe koha e hedhjes së tyre.

### **Kushtet për kryerjen e veprimtarive minerare**

#### **Neni 54**

Shoqëria tregtare, personi juridik dhe sipërmarrësi të përmendur në nenin 53 paragrafi 1 i këtij ligji duhet të ketë:

- Person përgjegjës;
- Të paktën një punonjës të cilit i është dhënë autorizim për kryerje të veprimtarive minerare në përputhje me këtë ligj;
- Objekt për magazinim, pra magazina për të cilat është dhënë leja e përdorimit.

Personi përgjegjës i përmendur në paragrafin 1 ndarja 1 të këtij neni, zotëron diplomë kolegji ose universitare për degën përkatëse dhe plotëson kushtet për administrim të përmendura në nenin 19 të këtij ligji.

## **Kërkesa për leje**

### **Neni 55**

Shoqëria tregtare, personi juridik dhe sipërmarrësi, me kërkesën për leje për kryerjen e veprimtarive minerare, bashkëngjit:

- Aktin për regjistrim në Regjistrin Qendror të Gjykatës Tregtare;
- Të dhënat për personin përgjegjës;
- Të dhënat për punonjës të cilit i është dhënë autorizim për kryerjen e veprimtarive minerare në përputhje me këtë ligj, dhe
- Dokument që vërteton pronësinë mbi një objekt magazinimi, domethënë mbi magazinat për të cilat është dhënë leje përdorimi.

## **Plani i veprimtarisë minerare dhe masat e sigurisë**

### **Neni 57**

Gjatë kryerjes së veprimtarive minerare, shoqëria tregtare, personi juridik ose sipërmarrësi, është i detyruar që të marrë masa sigurie dhe të kryejë veprimtari minerare sipas planit të tyre, në mënyrë që të mos rrezikohet jeta, shëndeti dhe siguria e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës.

Plani i veprimtarisë minerare të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përpunohet nga personi me diplomë universitare të industrisë së minierave dhe të ketë dhënë provimin e profesional, në përputhje me rregulloret për minierat.

Shoqëria tregtare, personi juridik dhe sipërmarrësi, i cili kryen veprimtaritë minerare, është i detyruar që për veprimtaritë të cilat kryhen në vend të banuar ose në afërsi të vendeve të banuara, jo më vonë se 24 orë para kryerjes së veprimtarisë minerare, të njoftojë ministrinë, organin administrativ kompetent për çështjet e policisë dhe publikun, nëpërmjet mjeteve të njoftimit publik, dhe tre ditë para kryerjes së veprimtarive minerare në afërsi të rrugëve, hekurudhave, sistemeve të furnizimit me ujë, linjave elektrike ose telefonike dhe objekteve të ngjashme, të njoftojë me shkrim shoqëritë tregtare ose persona të tjerë juridikë që i administrojnë këto objekte.

## **Autorizimi për kryerjen e veprimtarive minerare sipërfaqësore**

### **Neni 58**

Veprimtari minerare sipërfaqësore mund të kryhet nga punonjësi i përmendur në nenin 54 paragrafi 1 ndarja 3 të këtij ligji, të cilit i është dhënë leje për kryerjen e veprimtarive minerare sipërfaqësore.

Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni jepet nga ministria.

Autorizimi për kryerjen e veprimtarive minerare sipërfaqësore mund t'i jepet personit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, i cili:

- zotëron diplomë të shkollës së mesme, kolegji ose universitare për degën përkatëse;
- ka dhënë provimin e specialitetit për kryerjen e veprimtarive minerare, dhe
- ka katër vjet përvojë pune në punimet e përgatitjes së veprimtarisë minerare dhe zotëron diplomë të shkollës së mesme, ose dy vjet përvojë pune në këto punime dhe zotëron diplomë kolegji ose universitare.

## **Autorizimi për kryerjen e veprimtarive të veçanta minerare**

### **Neni 59**

Veprimtaritë e veçanta minerare mund të kryhen nga një punonjës i përmendur në nenin 54 paragrafi 1 ndarja 3 të këtij ligji, të cilit i është dhënë autorizimi për kryerjen e veprimtarive të veçanta minerare.

Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet nga ministria.

Autorizimi për kryerjen e veprimtarive të veçanta minerare mund t'i jepet personit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, i cili plotëson kushtet e nenit 19 paragrafi 1 i këtij ligji dhe:

- zotëron diplomë kolegji ose universitare për degën përkatëse;
- ka dhënë provimin e specialitetit për kryerjen e veprimtarive minerare; dhe
- ka pesë vjet përvojë pune në veprimtaritë minerare dhe zotëron diplomë kolegji ose katër vjet përvojë pune në këto veprimtari dhe zotëron diplomë universitare.

## **Autorizim për kryerjen e veprimtarive minerare në procesin e çminimit**

### **Neni 61**

Veprimtaria minerare në procesin e çminimit mund të kryhet nga punonjësi i përmendur në nenin 54 paragrafi 1 ndarja 3 të këtij ligji, të cilit i është dhënë autorizim për kryerjen e veprimtarive minerare gjatë çminimit.

Autorizimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni jepet nga ministria.

Autorizimi për kryerjen e veprimtarive minerare gjatë çminimit mund t'i jepet personit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, i cili:

- zotëron diplomë të shkollës së mesme, kolegji ose universitare për degën përkatëse;
- ka dhënë provimin e specialitetit për kryerjen e veprimtarive minerare;
- ka dy vjet përvojë pune në veprimtaritë minerare dhe të çminimit dhe zotëron diplomë të shkollës së mesme ose një vit përvojë pune në këto veprimtari dhe zotëron diplomë kolegji ose universitare.

## **Veprimet e përgatitjes së veprimtarive minerare**

### **Neni 63**

Veprimet për përgatitjen e veprimtarive minerare (mbushja e vrimave me plasës, vendosja e pajisjeve për aktivizim etj.) mund t'i kryejë person fizik (në vijim referuar si: minator) i cili:

- plotëson kushtet e përmendur në nenin 19 paragrafi 1 të këtij neni;
- zotëron të paktën diplomë të shkollës së mesme;
- është i kualifikuar për kryerjen e veprimtarive minerare, për të cilën ka vërtetim të dhënë në bazë të rregulloreve për minierat.

Punimet ndihmuese në përgatitje të veprimtarive minerare (transportimi i lëndëve plasëse, ngarkimi, shkarkimi etj.), mund t'i kryejë, nën mbikëqyrjen e minatorit, personi fizik që ka mbaruar shkollën e mesme i cili është njohur paraprakisht me mënyrën e punës, reziqet dhe rregullat e mbrojtjes gjatë administrimit të lëndëve plasëse.

## **Miratimi i aktit nënligjor**

### **Neni 75**

Përmbajtja e kërkesës dhe dokumentacionit për dhënie mendimi dhe miratimi të përmendur në nenin 66 të këtij ligji, distanca e sigurisë për të gjithë llojet e objekteve të prodhimit dhe magazinimit, kushtet që duhet të plotësojnë objektet e prodhimit dhe magazinimit dhe vendndodhja, si dhe mënyra e sigurimit të tyre fizik dhe teknik, përcaktohen me rregullore të ministrisë.

## **Mbajtja e evidencave**

### **Neni 76**

Ministria mban evidenca për:

- Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar, domethënë të emëruar për vlerësimin e përputhshmërisë së lëndëve plasëse;
- lëndët plasëse për të cilat është dhënë leje për tregtim;
- lejet e dhëna për prodhim, tregtim, blerje të lëndëve plasëse, për kryerjen e veprimtarive me fishekzjarrë publikë, hedhjen e fishekzjarrëve publike, kryerje të veprimtarisë minerare dhe autorizimin për kryerjen e veprimtarive minerare;
- vendimet e lëshuara për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për prodhim, tregtim të lëndëve plasëse, kryerjen e veprimtarive me fishekzjarrë publikë dhe për veprimtaritë minerare;
- kampionet e marra të lëndëve plasëse.

Shoqëria tregtare, personi juridik ose sipërmarrësi që prodhon lëndë plasëse, administron evidencë për llojin dhe sasinë e lëndëve plasëse të prodhuara, të shitura, të përdorura, të asgjësuar, të kthyer, të humbura ose të vjedhura.

Shoqëria tregtare, personi juridik dhe sipërmarrësi që kryejnë tregtimin, prokurim dhe/ose përdorimin e lëndëve plasëse, mbajnë evidencë për sasinë dhe llojin e lëndës plasëse të prokuruar, të shitur, të përdorur, të asgjësuar, të kthyer, të humbur ose të vjedhur.

Evidencat e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni ruhen për 10 vjet, ndërsa evidencat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni ruhen për pesë vjet.

Përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së evidencave të përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni përcaktohen nga ministria.

## **Masat dhe veprimet administrative**

### **Neni 79**

Krahas masave dhe veprimeve administrative të parashikuara me ligj me të cilin është rregulluar mbikëqyrja inspektuese, inspektori i lëndëve plasëse, i lëndëve, i lëngjeve edhe gazeve të ndezshme, është i autorizuar edhe që:

- të hyjë e të kontrollojë objektet dhe ambientet ku kryhet prodhimi, magazinimi, përdorimi, asgjësimi ose tregtimi i lëndëve plasëse, si dhe hapësirat për të cilat ka dyshime se në to ka lëndë plasëse;
- të kontrollojë dokumentacionin në lidhje me lëndët plasëse;
- të kontrollojë dokumentet mbi kualifikimin profesional për administrimin e lëndëve plasëse;
- të verifikojë dhe përcaktojë identitetin e personit që konstatohet në vendin e përdorimit, prodhimit dhe magazinimit të lëndëve plasëse;
- të ndalojë administrimin e lëndëve plasëse nga persona të cilët nuk janë të kualifikuar profesionalisht për këtë;
- të ndalojë prodhimin e lëndëve plasëse dhe veprime të caktuara në lidhje me tregtimin, magazinimin, përdorimin, ngarkimin ose shkarkimin e lëndëve plasëse për shkak të parregullsive të kryera gjatë marrjes së masave të sigurisë, të cilat mund të rrezikojnë jetën, shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës;
- të urdhërojë eliminimin e parregullsive të konstatuara brenda afatit të caktuar;
- të urdhërojë masa për prodhimin, tregtimin dhe përdorimin e lëndëve plasëse të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës.

### **Neni 80**

Me gjobë nga njëzetfishi deri në treqindfishin e shumës së pagës minimale në Malin e Zi, dënohet për shkelje shoqëria tregtare, personi juridik ose sipërmarrësi në qoftë se:

- 1) nuk miraton aktin e përgjithshëm sipas nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji;
- 2) personat të cilët administrojnë ose kryejnë veprime të tjera në lidhje me lëndët plasëse nuk i njej me masat e përcaktuara me aktet e përmendura në nenin 6 pika 2 të këtij ligji ose nuk i kualifikon ato për veprimet në rast aksidenti tekniko-teknologjik ose rreziku tjetër, brenda kuptimit të rregulloreve për mbrojtjen dhe shpëtimin (neni 7);
- 3) nuk siguron mbrojtje të përhershme fizike dhe teknike të objekteve në të cilat kryhet prodhim ose magazinimi i lëndëve plasëse (neni 8);
- 4) Nuk organizon dhe monitorin zbatimin e masave të përcaktuara për magazinimin (neni 9);
- 5) për humbjen ose vjedhjen e lëndëve plasëse nuk njofton menjëherë, ose të paktën brenda një ore pas marrjes së informacionit, ministrinë ose organin e administrativ kompetent për çështjet e policisë,(neni 10);
- 6) tregton dhe përdor lëndë plasëse pa leje për tregtim (neni 12 paragrafi 1);
- 7) kryen veprimtaritë e përmendura në nenin 13 të këtij ligji pa autorizim (neni 14 paragrafi 1);
- 8) lejon administrimin e lëndës plasëse nga një person i cili nuk plotëson kushtet për administrimin e lëndëve plasëse (neni 19 paragrafi 1);
- 9) fillon prodhimin e lëndëve plasëse pa lejen e ministrisë (neni 22 paragrafi 2) ose vazhdon prodhimin kur nuk i plotëson më kushtet e përmendura në nenin 23 të këtij ligji;
- 10) kryen kërkime për lloje të tjera lëndësh plasëse pa lejen e ministrisë (neni 28 paragrafi 3);
- 11) kryen tregtimin e lëndëve plasëse pa lejen e ministrisë (neni 32 paragrafi 1);
- 12) shet lëndë plasëse për shoqërinë tregtare, personat juridikë, sipërmarrësit ose personat fizikë, të cilët nuk kanë leje për prokurimin e lëndëve plasëse (neni 35);
- 13) blen lëndë plasëse pa lejen e ministrisë (neni 37 paragrafi 1);
- 14) hedh fishekzjarrë publikë pa lejen e ministrisë (neni 46 paragrafi 2);
- 15) kryen veprimtari minerare pa lejen e ministrisë (neni 53);

16) gjatë veprimtarive minerare, nuk ndërmerr masa sigurie për ruajtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës (neni 57 paragrafi 1);

17) me asgjësimin jo të rregullt dhe joprofesional të lëndëve plasëse, rrezikon jetën, shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës (neni 64 paragrafi 1 dhe 2);

18) objektet e prodhimit dhe magazinimit për lëndët plasëse nuk i ndërton dhe pajis në mënyrë që të garantohet mbrojtja e jetës, shëndetit dhe siguria e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës (neni 65);

19) objektet e prodhimit dhe magazinimit për lëndët plasëse i ndërton pa marrjen e vendimit për vendin dhe pa miratimin e projektit dhe dokumentacionit tekniko-financiar (neni 66);

20) kontejnerin e vendos në kundërshtim të dispozitave të nenit 67 të këtij ligji;

21) objektet e prodhimit dhe magazinimit i përdor pa autorizimin e ministrisë (neni 74).

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dënohet me gjobë, nga pesëfishi deri në njëzetfishin e pagës minimale në Malin e Zi, personi përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 81**

Me gjobë, nga njëzetfishi deri në dyqindfishi i pagës minimale në Malin e Zi, dënohet për shkelje shoqëria tregtare, personi juridik ose sipërmarrësi, në qoftë se:

1) lëndët plasëse administrohen nga një personi i cili nuk është i kualifikuar profesionalisht ndërsa nuk është nën mbikëqyrjen e personit i cili është i kualifikuar profesionalisht për administrimin e lëndëve plasëse dhe në qoftë se nuk është njohur paraprakisht me mënyrën e punës, rreziqet dhe masat e mbrojtjes në punë (neni 20 paragrafi 1);

2) brenda tetë ditësh nga vendimi përfundimtar për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për prodhim të lëndëve plasëse, nuk i dërgon ministrisë evidencat e mbajtura sipas këtij ligji (neni 26 paragrafi 2);

3) brenda tetë ditësh, nuk njofton ministrinë për fillimin, ndryshimet dhe ndërprerjen e ushtrimit të veprimtarive (neni 30);

4) brenda tetë ditësh nga data e vendimit përfundimtar për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për tregtimin e lëndëve plasëse, nuk i dërgon ministrisë evidencat e mbajtura në përputhje me dispozitat e këtij ligji (neni 36 paragrafi 2);

5) blen lëndë plasëse të nevojshme për kryerje të veprimtarive minerare dhe pajisje piroteknike për hedhjen e fishekzjarrëve në ambient publik mbi sasinë e lejuara (neni 40);

6) shet lëndë plasëse ndërsa nuk mban kopjen e lejes ose në leje nuk specifikon llojin dhe sasinë e lëndës plasëse të shitur (neni 41 paragrafi 2);

7) në kantier nuk ka kontejner për magazinimin e lëndëve plasëse të papërdorura (neni 42);

8) përdor lëndë plasëse të blera në kundërshtim me dispozitat e nenit 44 paragrafi 2 të këtij ligji;

9) brenda tetë ditëve nga vendimi përfundimtar për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për hedhjen e fishekzjarrëve në ambient publik, nuk i dërgon ministrisë evidencat e përcaktuara (neni 49 paragrafi 2);

10) hedh fishekzjarrë në ambient publik pa lehe ose hedh fishekzjarrë publike në vendin, në kohën, për llojin dhe kategorinë e pajisjeve piroteknike, në kundërshtim me lejen për hedhjen e fishekzjarrëve publike (neni 51);

11) brenda tetë ditëve nga data e vendimit përfundimtar për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për kryerjen e veprimtarive minerare, nuk i dërgon ministrisë evidencat e përcaktuara (neni 56 paragrafi 2);

12) nuk ndërmerr masa të sigurisë, nuk harton planin e veprimtarisë minerare ose nuk e kryen veprimtarinë sipas planit të saj (neni 57 paragrafi 1);

13) kryen veprimtari minerare në vend të banuar ose në afërsi të vendeve të banuara, ndërsa nuk ka njoftuar paraprakisht ministrinë, organin e administrativ kompetent për çështjet e policisë, publikun, shoqëritë tregtare dhe personat juridik që administrojnë rrugët, hekurudhat, sistemin e furnizimit me ujë, linjat elektrike ose telefonike ose objekte të ngjashme (neni 57 paragrafi 3);

14) veprimtaritë minerare sipërfaqësore, speciale, nëntokësore ose ato gjatë çminimit, kryhen nga persona të cilët nuk kanë leje për kryerje të veprimtarive minerare ose për lloje të caktuara të tyre (nenet 58, 59, 60 dhe 61);

15) veprimet e përgatitjes së veprimtarive minerare ose të punimeve ndihmuese në përgatitje

të veprimtarive minerare kryhen nga një person fizik i cili nuk plotëson kushtet e përmendura në nenin 63 i këtij ligji;

16) në objektin e prodhimit dhe magazinimit në të cilin ruhen shumë lloje lëndësh plasëse, nuk i vendos këto lëndë në dhoma të ndara ose në hapësira të ndërtuara posaçërisht për këtë, ose mjetet për ndezje i mban bashkërisht me lëndët plasëse (neni 68);

17) nuk mban dhe nuk ruan evidencat e përcaktuara (neni 76 paragrafi 2, 3 dhe 4).

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dënohet me gjobë, nga pesëfishi deri pesëmbëdhjetëfishi i pagës minimale në Malin e Zi, edhe personi përgjegjës në personin juridik.

### **Neni 82**

Me gjobë, nga trefishi deri në dhjetëfishin e pagës minimale në Malin e Zi, dënohet për shkelje personi fizik në qoftë se:

1) pas mbarimit të veprimtarisë, nuk i rikthen sasinë e mbetur të lëndëve plasëse, shoqërisë tregtare, personit juridik ose sipërmarrësit tek i cili i ka blerë ose nëse lëndët nuk asgjësohen nga një specialist i kualifikuar dhe për këtë nuk njofton ministrinë dhe organin e administrativ kompetent për çështjet e policisë (neni 38 paragrafi 4);

2) kryen veprimtaritë minerare sipërfaqësore, speciale dhe/ose nëntokësore dhe/ose gjatë çminimit, ndërsa nuk ka leje për kryerjen e tyre (neni 58 paragrafi 1, neni 59 paragrafi 1, neni 60 paragrafi 1 dhe neni 61 paragrafi 1);

3) kryen veprime të përgatitjes së veprimtarive minerare, ndërsa nuk plotëson kushtet e përmendura në nenin 63 paragrafi 1 të këtij ligji.

Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, personit fizik mund t'i komunikohet edhe gjoba në vendin e ngjarjes deri dyfishin e pagës minimale në Malin e Zi.

### **Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit me të cilat rregullohen gjobat për shkelje**

(“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi”, numër 40/11)

### **Neni 14**

Në ligjin për lëndët plasëse (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi”, numër 49/08) në nenin 80, fjalia hyrëse e paragrafit 1 ndryshohet dhe bëhet:

“Personi juridik dënohet me gjobë nga 1500 euro deri në 16 000 euro për shkelje në qoftë se:”

Në paragrafin 2 fjalët: “nga pesëfishi deri në njëzetfishin e pagës minimale në Malin e Zi” zëvendësohen me fjalët: “nga 300 euro deri 1500 euro”.

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri i cili bëhet:

“Sipërmarrësi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, dënohet me gjobë nga 750 euro deri në 4000 euro”.

Në nenin 81, fjalia hyrëse e paragrafit 1 ndryshohet dhe bëhet:

“Personi juridik dënohet me gjobë nga 1500 euro deri në 10 000 euro, për shkelje në qoftë se, ”:

Në paragrafin 2, fjalët: “nga pesëfishi deri pesëmbëdhjetëfishi i pagës minimale në Malin e Zi” zëvendësohen me fjalët: “nga 300 euro deri 1000 euro”.

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri i cili bëhet:

“Sipërmarrësi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, dënohet me gjobë nga 750 euro deri në 2500 euro”.

Në nenin 82, fjalia hyrëse e paragrafit 1 ndryshohet dhe bëhet:

“Personi fizik dënohet me gjobë nga 150 euro deri 550 euro për shkelje në qoftë se, ”:

Paragrafi 2 ndryshohet dhe bëhet:

“Për shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, personi fizik dënohet me gjobë në vlerën e 200 euro”.